



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:084540

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05278123

P.2021:084541

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, me Bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurës L.A. D. D., e shpallur fajtoresh për shkak të veprës penale të paraparë me 80 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet të KPRK-së dhe veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/IL.nr.411/21 të datës 29.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 16.01.2024, në seancë publike, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini dhe të pandehurës mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura L. A. D. D. nga fshati ..., Rruga ..., Komuna e Kaçanikut, e lindur më datë ..., nga i ati Z... dhe e ëma M... e gjinisë D..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e Ekonomisë, e martuar, prind i një fëmije, pronare e ndërmarrjes "...” SH.P.K, - me numër identifikues ..., e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës e Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

## I

Prej datës së pa vërtetuar e deri më 05.03.2021 në fshatin Gjurgjedell, Komuna e Kaçanikut, me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme me ndërmarrjen e saj “...” SH.P.K, në vazhdimësi ka ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm mineralar, në atë mënyrë që në ditën kritike inspektorët e KPMM kanë hasur se SHPK “...”, me pronare të pandehurën është duke kryer aktivitet të jashtëligjshëm pa posedim të licencës për shfrytëzimin e resurseve minerare të gurit të fortë në sasinë prej 358.00 m<sup>3</sup>, dhe si rrjedhojë e kësaj ka shkaktuar dëm 1,074.00€.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të paraparë me nenin 80 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet të KPRK-së.

## II.

E pandehura si në pikën e parë të këtij dispozitivi, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet me dashje ka degraduar tokën në zonën kadastrale të fshatin Gjurgjedell Komuna e Kaçanikut, ashtu që duke përdorë forcën mekanike një eskavator dhe një kamion ka shfrytëzuar resurset minerare-gjegjësisht gurin gëlqeror në kundërshtim me rregullat dhe pajisjet të shërbejnë për mbrojtjen nga rreziqet e tilla, dhe si rrjedhojë e kësaj fusha e materialit të shfrytëzuar është 146.166m<sup>2</sup>, ndërsa dëmi i shkaktuar mjedisor është në shumë prej 175.00€.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364, 452, 462 të KPPK-së, të pandehurës i:

## GJYKON

1. Për pikën I të dispozitivit i cakton dënim me gjobë në shumë 500€.

2. Për ikën II të dispozitivit i cakton dënim me gjobë në shumë 500€

Konform nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurën e:

## GJYKON

I. Me dënim unik me gjobë në shumë prej 1000€ (Një mijë euro), të cilën gjobë është e obliguar që ta paguaj në 2 këste mujore të barabarta, në afat prej 2 muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20€ (njëzetë euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil

III. Obligohet e pandehura që për shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën nga 50€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, ndaj të pandehurës L. A.D.D., për shkak të veprës penale të paraparë me 80 te Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minalet të KPRK-së dhe veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-së, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.411/21 të datës 29.04.2021.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 16.01.2024

Në këtë seancë në fazën e administrimit të provave e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se dënimet e procedurës administrative i ka paguar dhe i ka premtuar gjykatës së në të ardhmen do të jemi sa më të kujdesshëm.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurës, dhe ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë me të cilën janë akuzuar sipas aktakuze pasi që të njëjti bërën pranim vullnetar dhe një pranim i tillë ka mbështetje në provat që i përmban kjo aktakuzë dhe po ashtu është në pajtim me dispoziten e nenit 242 të KPP-së, në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpall fajtorë dhe ti shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, ka propozuar që me rastin e caktimit të dënimit për veprat penale në kuptim të nenit 69 si rrethanë lehtësues ta merr pranimin e fajësisë ndërsa si rrethanë rënduese të marrë shkallën e përgjegjësi penale motivet për kryerjen e veprës penale në rastin konkret përfitimi i dobisë pasurore si dhe rrethanat në cilat janë kryer veprat penale nga e pandehura dhe do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së

#### *Vlerësimi i pranimin të fajësisë*

Pasi që e pandehura e ka pranuar fajësinë, para përfundimit të procedurës së provave, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: e pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rasti konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin figurës së veprës penale gjykata konstatoi se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të paraparë me

80 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet të KPRK-së dhe veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### *Rrethanat për matjen e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se të njëjtit e ka pranuar fajësinë, deklarin se është pënuar për veprimet e kryera, premtimin se nuk do të përsërit vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese përpos atyre kualifikuese nuk u gjetën.

Gjykata, të pandehurës i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

#### *Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike*

Vendimi për udhëzimin në kontest civil të palëve të dëmtuara është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

#### *Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242, 364 dhe 462 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2021:084541, datë 05.02.2024

Procesmbajtës:

Ismail Kuçi

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë,